



Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të tretë të rregullt të BISHZ-së më 09.12.2000

Vendi: Qendra Shqiptare, Seftigenstrasse 57, 3000 Bern
Data: E shtunë, 9 dhjetor 1999 / 14.00 - 17.00
Protokoli: Sinollah Shehu (sekretar)
Pjesëmarrës: Ca. 20

Pikat e rendit të ditës:

1. Përshëndetja e të pranishmëve - hapja e Kuvendit
 2. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 12.12.1999 - 08.12.2000
 3. Të ndryshme
-

1. Përshëndetja e të pranishmëve – hapja e Kuvendit

Nazmi Jakurti i përshëndeti të gjithë të pranishmit si dhe në veçanti musafirët e fëtuar zotëri Pjetër Rodiqin dhe Skender Nikoliqin nga Këshillimorja shqiptare në Basel.

2. Raporti vjetor i BISHZ-së prej 12.12.1999 deri më 08.12.2000

Dokumenti “Raporti vjetor i BISHZ-së prej 12.12.1999 deri më 08.12.2000 u është shpërndarë të pranishëmve.

Kryetari, dipl. jur. Nazmi Jakurti e lexoi raportin e aktivitetit të BISHZ-së për periudhën dhjetor 1998 - dhjetor 1999.

Pas leximit të raportit është debatuar lidhur me përmbajtjen e tij. Në diskutime morrën pjesë: zotëri Vllaznim Nevzati, zotëri Pjetër Rodiqi, zotëri Enver Pula, sekretari Sinollah Shehu, nënkryetari Xhevat Salihu, anëtar i kryesisë Ahmet Xhigoli dhe arkëtari Ismet Rexhaj. **Në përfundim të kësaj pike pas vërejtjeve të bëra për shkak të jo strukturimit të të dhënave sipas raporteve të mëparshme dhe përfshirjes së të dhënave të pa paraqitura, mungesës së pjesës financiare (bilancit), dhe mungesës së marrveshjeve me shkrim të evidentua në raport, raporti është aprovuar. Strukturimin e tij do ta bën z. Xhigoli.**



3. Të ndryshme

- Kryetari, Nazmi Jakurtri ndau tri mirënjohje. Një për nënkryetarin e BISHZ-së Xhevat Salihu, një për sekretarin e BISHZ-së Sinollah Shehu dhe një për anëratin e kryesisë dhe kryeredaktorin e revistës "Bashkimi", Ahmet Xhigoli.

Në fund të punimeve të Kuvendit të tretë të rregullt, Sekretariati i BISHZ-së, organizoi një koktej për të pranishmit.

Mbledhja e Kuvendit zgjati prej orës 14:00 deri në ora 17:00.

Udhëhqësi i protokolit: inxh. i dipl. Sinollah Shehu

Sisseln, 20 dhjetor 2000